



Bërja e një Ankese

Komisioni Australian i të Drejtave të Njeriut është organ i parvarur që hulumton dhe zgjidh ankesa rreth seksit, racës, paaftësisë dhe diskriminimit ndaj moshës, diskriminime ILO III dhe diskriminime dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Gjërat për të cilat mund të ankoheni tek ne

- **Discriminim seksual** përfshin ngacmime seksuale dhe diskriminim bazuar në seks, identifikimin gjinor, statusit interseks, shtatzënisë dhe statusit martesor dhe të relative, ushqyerja me gji, përgjegjësitë familjare dhe orientimi seksual..
- **Diskriminimi ndaj paaftësisë** përfshin diskriminimin bazuar në paaftësitë fizike, intelektuale, shqisore, paaftësitë e të mësuarit dhe psiqike. Sëmundje, gjendjet mjeksore, dëmtimet të pësuar në punë, paaftësitë e së kaluarës, të tanishme dhe të së ardhmes, si dhe mjetet për ndihmë të personave të paaftë, dhe shoqërimi me një person me paaftësi.
- **Diskriminim racor** përfshin urrjetje racore, dhe diskriminim bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje, origjinën kombëtare dhe etnik, dhe statusin e emigrimit.
- **Discriminim ndaj Moshës** përfshin diskriminim bazuar në të qenit tepër i ri ose tepër i moshuar.
- **Diskriminim ILO III** përfshin diskriminim bazuar në fenë, dosje penale, aktivitetin në sindikatë, opinionin politik dhe origjinën sociale.
- **Të drejtat e njeriut** përfshin veprimet nga ose për komonuellthin që pretendohet që shkelin instrumentat e të drejtave specifike ndërkombëtare të njeriut, si Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa mbi të drejtat e Fëmijëve dhe Konventa mbi të Drejtat e Personave me Paaftësi.

Mund të bëni ankesë kudo që të ndodhëni në Australi dhe nuk ju kushton asgjë që të bëni një ankesë. Hapat e bërjes së një ankese janë të vëna në listë si më poshtë:

Bëni një kërkesë

- Në se nuk jeni të sigurtë në se keni mundësi të bëni ankesë për diçka, mund ta kontaktoni Shërbimin Kombëtar Informativ të Komisionit me telefon: **1300 656 419** ose me email: infoservice@humanrights.com.au
- Ne mund tua dërgojmë një formular ankese për ta filluar procesin

- Nëse nuk kemi mundësi t'ju ndihmojmë do të përpiqemi t'ju referojmë tek dikush që mund t'ju ndihmojë.

Bërja e njw ankese

- Ankesa duhet të jetë me shkrim. Mund ta plotësoni një formular ankese dhe te na postoni ose të na dërgoni me faks ose mund ta bëni kërkesën në internet në faqen tonë të internetit: www.humanrights.gov.au
- Mund të bëni ankesë në gjuhën tuaj të preferuar dhe ne mund t'ju ndihmojmë ta shkruani ankesën tuaj nëse kjo gjë është e nevojshme.
- Nuk keni nevojë për avokat për të bërë një ankesë.
- Nëse ne nuk kemi mundësi të merremi me ankesën tuaj do tua shpjegojmë se pse.

Hetim

- Ne do t'ju kontaktojmë që të flasim për çështjen tuaj dhe ka mundësi që t'ju kërkojmë të na jepni më shumë informacione.
- Zakonisht komisioni kontakton personin ose organizatën për të cilët ju po ankoheni dhe ua japim atyre një kopje të ankesës suaj. Ne mund t'ju kërkojmë atyre informacione specifike dhe/ose një përgjigje ndaj ankesës suaj. Informacioni që i jepet komisionit si përgjigje e ankesës suaj, mund të përmbaj informacione personale si dhe të ndjeshëm rreth jush.
- Në disa raste ne mund të vendosim të mos vazhdojmë të merremi me ankesën tuaj. Nëse ndodh kjo, ne ua shpjegojmë arsyen pse.
- Ne mund të flasim me ju që të përpiqemi ta zgjidhim çështjen me pajtim.

Pajtim

- Pajtim do të thotë që ne përpiqemi t'ju ndihmojmë ju dhe personin ose organizatën për të cilën po ankoheni për ta gjetur një rrugë për ta zgjidhur çështjen.
- Pajtimi mund të bëhet në një mbledhje në prezecën e njëri tjetrit që quhet "Konferenë Pajtimi" ose nepërmjet një konference me telefon. Në disa raste çështjet mund të zgjidhen nepërmjet shkëmbimit me anë të emailleve, dhe bisedime me pajtuesin.
- Ankesat mund të zgjidhen në shumë mënyra të ndryshme. Për shembull me anë të një kërkesë për falje, ndryshim të politikës, ose kompensim.

Aksion i mundshëm Gjyqësor- diskriminim për arsye: seks, paaftësi, racë dhe moshë

- Komisioni nuk e ka fuqinë të vendosi nëse ka ndodhur diskriminim i paligjshëm

- Nëse ankesa e juaj nuk zgjidhet, ose ndërpritet për ndonjë arsye tjetër, ka mundësi ta dërgoni çështjen në gjykatë. Gjykata mund të vendos nëse ka patur diskriminacion të paligjshëm.
- Keni 60 ditë kohë nga data që komisioni ndërpret ankesën për të bërë aplikimin drejtuar Federal Circuit Court of Australia (Gjykata e Qarkut Federal të Australisë) ose Federal Court of Australia (Gjykata Federale e Australisë.)
- Komisioni nuk mund të çështjen në gjyq për ju dhe as t'ju ndihmojë ta paraqisni çështjen tuaj në gjyq.
- Ndoshta ju nevojitet të bisedoni me avokat ose një shërbim juridik nëse dëshironi të shkoni në gjyq.

Vendim/Raport - ILO III diskriminim dhe të drejtat e njerit

- Nëse ankesa nuk zgjidhet dhe as nuk ndërpritet çështja për ndonjë arsye tjetër, Presidenti i Komisionit mund të vendos nëse diskriminimi ILO III ose shkelja e të drejtave të njeriut ka ndodhur.
- Nëse Presidenti është i bindur që diskriminimi ose një shkelje e të drejtave të njeriut ka ndodhur, Presidenti mund ta raportojë çështjen tek Prokurori i Përgjithshëm Federal. Në raport Presidenti mund të rekomandojë dëmshpërblim për humbje ose dëmtim që një personi ka pësuar. Raporti mund të parashtrohet në Parlament.
- Shembujt e vendimeve të Presidentit rreth diskriminimit dhe të drejtat e njeriut gjenden në faqen e internetit të Komisionit:
<http://www.humanrights.gov.au/publications/reports-minister-under-ahrc-act>

Ku mund të gjej informacione të tjera?

Detajet e kontaktit të Komisionit të të Drejtave të Njeriut janë:

Telefon

National Information Service (Shërbimi Kombëtar Informativ) 1300 656 419
TTY: 1800 620 241
NRS: 133 677
Faks: (02) 9284 9611

Nëse keni nevojë për përkthyes mund të thërrisni: **131 450** dhe kërkoni që t'ju lidhin me Komisionin Australian të të Drejtave të Njeriut.

Nëse jeni shurdhër ose keni një dobësim të dëgjimit apo të folurit mund të na kontaktoni gjithashtu nepërmjet National Relay Service (NRS) (Shërbimi Kombëtar Rele) me numrin: 133 677. Nëse keni nevojë për një përkthyes AUSLAN ne kemi mundësi tua gjejmë.

Nëse jeni i verbër ose keni një dobësim të shikimit ne mund t'ju ofrojmë informacion në formate alternative sipas kërkesës.

Adresa Postare

NATIONAL INFORMATION SERVICE

telephone 1300 656 419 or (02) 9284 9888 • www.humanrights.gov.au • infoservice@humanrights.gov.au
April 2020

GPO Box 5218
Sydney NSW 2001

Online

Email: infoservice@humanrights.gov.au

Faqja e internetit: www.humanrights.gov.au

Mund ta bëni kërkesën online duke u drejtuar në:

<http://www.humanrights.gov.au/complaints/lodging-your-complaint>.

Këshillime të përgjithshme juridike

Nëse keni ndërmend të ankoheni, mund të dëshironi të këshilloheni me persona juridik. Ka shërbime juridike të komunitetit që ju ofrojnë këshillime falas rreth diskriminimit dhe ngacmimeve.

Mund të kontaktoni një organizatë për Ndihmë Juridike :

<http://www.nationallegalaid.org//for-individuals/> Ose takohuni me qendrën tuaj më të afërt të komunitetit. www.naclc.org.au/directory

Përgjegjësia: informacioni në këtë fletë fakti është menduar vetëm si një udhëzues. Nuk është një zëvendësimi i këshillave juridike.